## PREK TRUPIN E NJERIUT.

Dua tē prek trupin e njeriut, tē lehtin, tē lirin,  
gazplotin e jetëdhënësin trup, tē marr e tē jap  
dritë, guxim e mençuri... Puthmë! Ç'është kështu  
me ty?!

E ndien veten tē lodhur e tē plakur nga një  
mendim nator,  
që mbjell harresë e vetmi... Dhe trembesh si fëmi.  
Ç'rëndësi ka mosha?! Puthmë! Ç'është kështu me  
ty?!

Prek trupin e njeriut, tē lehtin, tē lirin,  
gazplotin e jetëdhënësin trup, merr e jep dritë.  
Vetëm prekja e njeriut  
është kundër shurdhimit, harresës, vëtmisë,  
vetëm prekja e njeriut.

Shëtiti mollëzat e gishtave në supe, krahë, në ballë  
vetulla e sy, futi gishtat në shkurren e flokëve  
dhe dëgjo  
së këndoijnë zogjtë e dashurisë në buzë... Nesër  
agu do ta largojë këtë mendim nator, më beso,  
nesër do tē jetë shuar krejt.

Do ta ndiesh veten tē freskët, tē lehtë;  
do tē zgjedhësh fustanin luleshumë, buzëkuqin  
e ndezur,  
do tē krihesh me kujdes...  
do tē shtosh buzëqeshjen... .

*E mrekullueshme do të jesh nesër,  
si mëngjes mesprilli verior, si vajzë e dashuruar  
do të ndihesh nesër, më beso,  
nesër kur të prekë dita — jetë që sapo ka filluar...  
Puthmë! Prek trupin e njeriut, marr e jap  
pafundësi  
mbushur plot e përplot dashuri.*

**Kukës, 1986**

## ...MBI VETULLËN TËNDE PO ULET DIELLI

Dy partizanëve që siguruan sulmin  
e pesëdhjetë shokëve...

Edhe nëse ne do të vdesim pa takuar të mirat nëna;  
ti, Dik, pa përkundur motakun në djepin prej arre  
që ndërtove vetë,

ti, baba, burrë i një gruaje të thjeshtë  
dhe unë pa takuar gruan time të re

që lufta po i turbullon lindjen;

kjo është e prekshme si ky gur...

Po në asnje mënyrë s'kemi kohë të vdesim  
gjer nesër, burrë,

gjer në mesnatë, në muzg,

a të paktën gjer në perëndim të diellit,

kur shokët do të kenë sulmuar.

Oh, përpara s'ka se si të vdesim!

Dik,

mbi vetullën tënde po ulet dielli  
e me duar të kuqe po të qetëson,

Dik,

thuaj, thuaj diellit të mos perëndoje!

Edhe nëse ne do të vdesim pa iu gjëzuar ditës së re,  
tokës së plleshme

*me bukë e dritë për të gjithë,  
kjo s'do të thotë se fëmija yt dhe imi që do të lindë  
s'do t'i gëzohen kaltërsisë e dashurisë...  
Dhe ajo orë, ajo orë kur do të gëzojnë fëmijtë  
me bukë të ngrohtë e dritë,  
e vërteta e luftës sonë është, Dik,*

*Le të rrjedhë gjaku përmbi vetull  
dhe në kofshën time le të rrjedhë,  
me një plumb s'mund të vdesim kurrsesi,  
as me treqind, tre mijë.  
Duhen mijëra plumbë për ne të dy....,*

*Dik,  
mbi vetullën tënde është ulur dielli  
e me duar të kuqe po të qetëson,  
Dik,  
thuaj, thuaj diellit të mos perëndoje!  
Dik,  
miku i diellit, shoku im...*

## XIXËLLONJA

(Kallëzim për martesën e nënës)

S'kishim asgjë të na falte gaz e prehje atë natë të  
errët martesore  
dhe nuk e di ç'mund të mbanim mend  
të mos ish ardhja e një xixëllonje...  
Pranë njëri-tjetrit, mbi krevatin e vjetër dhe larg,  
(sa larg!).

Përballë nesh jona ish  
edhe një arkëz e vogël me copëza fasheta  
për mentesha.

E gjora! Sikur vinte nga lufta!  
Në luftë të re hynte — prapavijë besnikë  
ku ruhej buka.  
... As fjalë s'kishim. Jona ish dhe heshtja.  
Një heshtje e gjatë dhe e egër na errte e na errte  
dhe zor ta hiqnim qafe asaj nate  
të mos vinte xixëllonja,  
që digjej e digjej për ne të dy,  
në buzët e tua, në syt' e mi.  
Ishim kaq të lodhur, kaq të shqetësuar...  
(Patriarkalizmi na rëndonte gjokset)  
... E s'e trazuam.

*E s'u gëzuam:*

*S'kishim asgjë tē na falte gaz e prehje atē natē tē  
errët martesore  
dhe nuk e di ç'mund tē mbanim mend  
tē mos ish ardhja e asaj xixëllonje...*

**1987**

## ATJE NË QAFË, NË KOLESJAN...

*Mos e çoni atje në Qafë, ku të heshturit flenë varg  
e varg!*

*Vijnë mjegullat e mbulojnë,  
borojnë borat e rëndojnë,  
rrjedhin shirat e rrënojnë...*

*Në mes të gurit më të madh një varr të pushojë  
pak*

*ai burrë që prehje s'pat kurrë —  
90 vjet pushkë e flamur.*

*Po ju, gjëmëtarë shurdhë e zemërgurë, atje në  
Qafë në Kolesjan,*

*me dhë e mbuluat Babën Lam.*

*E unë fëmi mbi avlli rri në shi e qaj për ty...*

---

Islam Spahiu — patriot, prijës i lumjanëve në vitet 1904-1913, i njojur me emrin Baba Lam i Lumës.

## P L E Q T È

*Si mjegulla, biri im, si mjegulla:  
aty jemi,  
aty s'jemi...  
na zhbën një er' e lehtë.  
Te ju mbështetemi,  
marrim jetë.*

## RRI KËTU ME GJËRAT E TUA

*Rri këtu me gjërat e tua: rrroba, libra, vizione të shkuara, s'më bëjnë këmbët të ngrihem, të dal dhe s'them asnjë fjalë. (Paskam 1000 vjet pa të parë!)*

*Shi vitesh derdhet në muà. Rri këtu me gjërat e tua...*

## SY PËR SY...

### 1 — Panteoni i rralluar

*Me lot në sy ta përpiva stuhinë e fjalëve  
burrë,  
e mora vesh se je gjallë në mes të gjallëve,  
në luftë e bash midis logut,  
sy për sy e dhëmb për dhëmb me bajlozat e tokës...  
... Mbi supet tona atë ditë i bardhë ishe krejt,  
pa pikë gjaku trupi me nëntë plagë... Atë ditë  
e fale gjakun në tokë e njerëz. Lotët iu terën  
motrës,  
nga shkrumb' i shtypjes gjithçka nisi të gjethojë  
at' orë,  
kur ne u ndamë përjetë, Gjergj...  
Trokoi një kohë e gjak i stërnipërve pikë-pikë  
pikoi mbi ty.  
(E di, s'mund të rrije shtrirë atje, nën dhé,  
në qetësinë e të vdekurve...)  
Ai gjak nga gjumi qindravjeçar të zgjoi,  
s'të dha as kohë për shtriqje: selvia t'u bë kalë,  
zogu i verës furtunë, forcë lotët e motrës.  
... Dhe hyre në luftë, burrë, logu të priste,  
Qe ku m'u shfaq ftyra jote e kërleshur.  
Prej barit të padurimit mijëravjeçar nxin,*

*flokët e squllur era tokë binin. Trupi gjithashtu.*

*Veç sytë po atë — të zjarrtë si lava. —*

*dy shkrepje rrufeje,*

*eshtrat po ato — burrërore, të mëdhë,*

*me lëmyshkun e shkëmbinjve.*

*(Asnjë orë s'kishe fjetur, Gjergj,  
njeritokë, tokënjeri, i zakonshmi perëndi, e ne,  
e ne të dinim të vdekur!)*

*Kur në heshtjen e rishfaqjes të gjithë prisin*

*bërë gur,*

*me rropamë nofullat u çanë: shqip thanë fjalë.*

*(Oooo, pas kaq kohëtash heshtjeje, thashë, gjuha  
ka mësuar veç fjalë vdekjeje!)*

*Po në log të mejdavit qiejt u çanë: u kapërthyen  
erëra, ré,*

*bubullima, shqyen mjegulla, furtunat, vetëtimat  
hynë te njëra-tjetra,*

*u përgjak heshtja...*

*Pikëllima jote nisi orteqet e fjalëve për të drejtat  
e të gjallëve.*

*Dhe sytë, dhe eshtrat, dhe fjala shqipe — krejt ti,  
Gjergj,*

*ta puthsha ballin!*

*Se logu s'është lojë, e din mirë. Është bukur zor qenka  
me dalë në log të mejdavit me topuzin e fjalës  
e një mijë bajloza të rinj me i rrafshitë menjëherë  
e duhma e gjakut tri mijë vjet me qelbë dhenë...  
...Thashë s'e m'u shkrete, Gjergj, firove në dhë*

*e shenjat e varrit u tretën, thashë, e s'po gjej  
— nga e ke kryet,  
thashë pa një bozhur më mbete, pa një lule të egër,*

— *Këngën po ta nis me zogun tënd të verës...*  
*Thashë po dergjesh për një pikë ujë nga kjo gjëmë*  
e re  
*me nëntë mijë plagë në trup mbi dhë e nën dhë.*  
*Prej plumbash pa zhurmë, thashë, m'u like*  
*në ndonjë luftë pagojse me shkronja cirilike,*  
*me gjarpërinj, thika a helm, thashë emri t'u*  
shkret...  
...*Ti ngjeshë në shpinë të gjogut me topuzin e*  
fjalës  
*e bash midis logut.*  
*Po unë kot, krejt kot po trembem për ty, se ti*  
je Gjergj  
*e veç nga logu në log ke jetë.*

## Verë, 1985

### 2 — Pranë kështjellës

*Prekim rrënojën e Sfetigradit, as qeshim, as*  
flasim.  
*Ecim nëpër diell e ngjyra.*  
*Veç kryet kthejmë shpesh... Atje,*  
*atje përtej shtrihet dhimbja.*

### 3 — Eshtë koha të duhemis

Mirë qofsh, vëlla i madh i fjalëve të gjalla  
fluturuese për te njeriu,  
shpirtkalluri i fjalëve të bardha si bora e virgjër  
e Pikëllimës!

Mirë jemi të gjithë!

Dje gjithë ditën e lume peshkova Drin e Bardhë  
e Drinin e Zi,  
s'e di qysh m'u dha e u çmalla, fola e fola me  
Gjalicën si me ty...

Në darkë djali m'u derdh n'grykë e fort iu çel  
gjahut të mbarë

— Të lumtë, babë, tha. Sonte kemi miq!

Mbrëmë kisha mik Lumin, o i lumi vëlla,  
qejf e mërzi deri n'tavan kemi ba...

Darkuam ngjala, të Drinit të Bardhë e krap të  
Drinit të Zi,  
dhanë e morën përralla me Arbërin gjer në  
mesnatë, sa u pakën  
e befas Lumi erdh e m'u nxi si moti për shi,  
u rrrol e fol, o gur... I ziu unë, thashë, mikù m'u  
ftoh, m'u prek!

Dhashë e mora me të mirë e fjalë e besë ia qita  
në pëllëmbë të dorës,  
e pashë se besë më kish zënë dhe sekretin e ka  
folë:

**E kish djegë flaka e mallit për ty, vëlla.**

**Atbotë u shprangova, u lehtova. I zoti isha ta**

**mbush me Ali,**

**vrik në këmbë e librin tënd në duart e Lumin e  
lëshova dhe nisi çmallja.**

**E gjithë natën e lume pa gjumë kemi ndejtë,**

**o i lumi vëlla,**

**me shpirtin tënd në duar, për besë... Lexo unë e  
lexo Zana ime,**

**që fort i ngjante me Fitore Podrimjen. E Lumi  
prek me gishta fjalët**

**si buzët, si gojën tënde të paheshtur.**

**Sa te njëri e te tjetri i zgjatnin krahët lastarë të  
rinj**

**Lumi yt e Arbëri im. Dhe asnje minutë heshtje  
nuk është.**

**Dhimbja mes nesh nuk matej më me centimetër  
a metër,**

**me hapësirë dhimbja matej... Pa an'e cak ish.**

**Planet.**

**Aiiiiiih, Ali Podrimja, lot e gaz të madh kemi pasë,  
qejj e mërzi deri n'tavan kemi ba!...**

**Pranverë, 1987**

4 — Ti e di si duhet jetuar...

*Ti e di si duhet vdekur të jetojë plisi i bardhë e gjaku i valë,  
tamli në sisë e fara në arë,  
ti e di si duhet jetuar, vëllai im i heshtur, vullkan  
i ndezur,  
vëllai im i tretur, i pabuzëqeshur, i fyer e i poshtëruar,  
vëllai im i panënshtruar...*

*Ke kaq shtatore në udhë e sheshe, modele bijsh hyjni jetojnë në ty:  
ata si farën në arë kryet lanë në kohën tënde prej gjaku dhe èndrre.*

*Ti e di si duhet vdekur, vëllai im i heshtur,  
vullkan i ndezur,  
ti e di si duhet jetuar...*

## FJALËT PRANË TEJE...

...Asnjë për bë s'u gjendka mbi dhë,  
një fjalë për mall  
në këtë orë të dridhshme, kaq të pritshme,  
vëç duar që preken, gishta që treten,  
veç sy që prehen, vështirime që s'tremben,  
veç buzë që puthen, gjokse që duhen,  
veç zjarr që djeg, zemër që troket  
e asnjë fjalë për bë mbi dhë,  
një fjalë për mall...

## MË DUAJ...

Më duaj ...dhe vuaj. Hidhu mbi mua si era  
mbi pemët,

e lirë, e stuhishme, diellore!

Oh!

Një orë do të tretem krejt nga drojtja jote.

## ... EDHE KATËR ORË TË VOGLA

*Edhe katër orë të vogla si duar fëmije  
ende janë mes meje e teje, vetëm katër orë  
që na bashkojnë me prekjen e ngrohtë,  
me heshtjen që flet, vështrime.*

*(Oh, si e mat kohën dashuria, zemra ime!)  
Pastaj ky çast në emrat tanë i ndarë përgjysmë  
kujtimit do t'i japë frymë...*

## MOS MA MBYLL DERËN! . .

*Mos ma mbyll derën të ndiej ecjen, fërgëllimin  
e shtatit të derdhur,  
vështrimin e shpejtë të ndiej! Mos ma mbyll derën  
të ndiej erën e sapunit që vdes pak e nga pak  
nga prekja e trupit tënd!  
Dhe njeriu veç për njeriun tretet...*

## PËR FËMIJËT E MI

Për ju në çdo orë të natës vdes, rilindem  
në çdo orë të ditës. Në qeshjen tuaj rritem,  
në vajin shkrihem... Dhe dridhem... dridhem...

## PEIZAZH ME HËNË PAS SHIUT...

*Pas një dite përvëluese  
se nga erdh një shi i hollë —  
napë e lagur në përflekjen e buzëve.*

*Pastaj u dha hëna e plotë  
si fytyr' e shëndetshme.  
Dhe toka u shfaq me margaritarët e saj,  
e heshtur dhe e larë...  
...Thua kish pritur vetëm një buzëqeshje.*

## KUJTIM PËR NJË DASHURI TË SHKUAR...

Mos qaj, zogu im, mos qaj! Kjo është veç një tymnajë.

Në dhomën tonë kënga do të nisë prapë e prej cicërimës sate do të plasin lule të voçkla në ajër e në sendet rrëth e qark, me fjalëza të kaltra do të mbushet dhoma... Kjo është veç një tymnajë kalimtare, një tymnajë bëdharake,

zëre se s'i hapëm dyer e dritare dhe loton krejt pa shkak të vërtetë, loton duke qeshur...

Hajt, pra, lotojmë duke qeshur!

...Po një pikë lot s'e nxirrja dot. Isha djalosh pa asnje dhimbë në gjoks.

Veç sot e asaj dite më thahet fytyra për ty, e gjora ime...

E krejt papritur më kap një mall i dhimbshëm dhe qaj dhe qaj krejt papritur... Qaj, zogu im, qaj!

## Z I L I A

### ЛУТИЯ МАСНОВИЧ

...Nisi me një guriçkë në dhëmbin e parë. Unë  
qeshja,  
ti vrapoje pas meje. Ikja si shiu prej reje,  
fshihesha pas plepit trupgjerë.  
gëzonim bashkë, gëzonte bot' e tërë.  
Në lojë fëmijërie hidheshin zogjtë, ajri i mesditës,  
gjethet  
dhe s'doja gjë tjetër...  
Ku ta dija se në gishtat e tu plumbin e parë  
kishte zilia?!

Heshtën zogjtë, ajri i mesditës u rëndua,  
gjethet ngrinë, zverdhën nga çudia.  
Terrova unë, terroi bot' e tërë,  
pastaj e qeshura jote me ligësi trishtoi çdo gjë.  
...Në moshën e burrit grushta të rëndë më dhuroi  
zilia

(Mes dhëmbëve të bardhë nxin dhëmb' i zi.)  
S'janë më bebëzat e mia shqyer nga habia,  
brenda tyre trishton pikëllimi për ty.  
Nga dita në ditë u nxive tek unë i gjithë,  
ti, bir i njeriut, adoptuar prej zilisë...

KĒSHILLA E PARĒ E BABAIT NĒ  
MOSHĒ TĒ RRITUR

*Ai qē mban lotin nē sy  
një mal brengë ka aty.*

Poemë  
M A L L

C'janë udhët midis nesh, fjalët që s'i flasim?  
Unë malet kam, ti detin. Dhe jemi te njëri-tjetri,  
me njëri-tjetrin...

... qëndrueshëm është që tashmë  
në këtë vëllazëri është që  
njëri-tjetri është që tashmë  
në këtë vëllazëri.

... qëndrueshëm është që tashmë  
në këtë vëllazëri është që tashmë  
njëri-tjetri është që tashmë  
njëri-tjetri është që tashmë  
njëri-tjetri është që tashmë  
njëri-tjetri është që tashmë  
njëri-tjetri.

## UNE, I ZAKONSHMI YT

*Shpesh shpërthëj e dal prej gjoksit tim si Drini  
në vjeshtë, shpesh, sa shpesh!*

*Ki durim! Jam në mrekullinë e krijimit.  
Nga shtegtim i vrullshëm shpejt do të kthej  
te i zakonshmi yt i drojtur. Ki durim!*

*Asgjë e ligë s'del prej gjoksit tim. Ki durim  
dhe besim,  
edhe pse je e lodhur më ofro fisnikëri e mirësi  
(Pak, oh sa pak!)*

*Dhe shih,  
kur të jem qetësuar një mal do të jap...  
Dora jote mbi ballë,  
një përkëdhelje dridhëse, e dashura ime,  
një shëtitje dashamirëse e gishtërinjve  
mbi vullkanin tim në shpërthim,  
një fjalë e mirë... Heshtje, heshtje e mençur.*

*Dhe shih,  
nga çasti solemn i krijimit do të kthejë  
i mrekulluar e i çliruar dhjetëfish,  
i drojturi, i treturi, i zakonshmi yt.*

# Poemë

1) Ajo ritë pa  
ose katër këngë  
dhe katër pushime  
të vogla...

Shëpshëndje e madhe e shtëpive. Në këtë kohë nuk duhet t'ju bënë shkak.

ë shtëpia  
tu frumë durrësi matematik të hulumta,  
Nëse më i rriti kësaj kohë  
në qytetin e vjetër që lindet nga bukura qëndruese  
Këtijat tu frumë shëpshëndje e shtëpia tu qytetit

lindur pa lupeja në durrësi, mbi këndin  
bëzhicëshëm, që  
nderenjaf përfshin

Lindur të brezitshëm pa durrësi, me reflektor  
përfshin të tilla veshjet  
s, telefonit var kohët. Guselci e Nëvratit  
Lash,

budrimi i përditës ajeli të fjetur  
me çdo shkallë vesh pëllgjet në dhomë  
që është njeqitë frumë apo lupeja me frida...  
Nuk do të nxit në kohët këtij

Vetëm së  
me jeshinë rreverë t'i përkthesh ura e njëkunë  
që t'ju ka vënë, t'i palej.

Poems  
of the people  
of the world



## 1) Ajo ditë pa ty

Nuk dua të hyj këtu! Kurrë më, kurrë!

Shtëpi e madhe shkretuar. Në barkun e shuar  
një dhomë

e ftohtë  
pa frysme dergjet me sende të heshtura.

Jeta nxitimthi ka kaluar  
nëpër rrëmujën që hesht nga hutimi për humbjen.

Rrobat — forma të vockla të trupit që s'është  
më —  
hedhur pa kujdes në shtrojë, mbi krevatin  
bashkëshortor,

ëndërrojnë për të.

Lodra të braktisura pa dashje, një reflektor  
që deshi të të ngrohë  
si luledielli var kokën. Guacka e krevatthit —  
bosh,

bodrum i errët sjell të ftohtë,  
me cipë të akullt vesh gjithçka në dhomë  
dhe të ngrohtën frysme apo hyra ma dridh...  
Nuk dua të hyj më këtu! Kurrë!

Vetëm sot

me gishtat rinorë t'i përkëdhel rrobat e pikëlluara  
për trupin tënd, t'i paloj,

(Asnjëherë s'do t'i veshim ato... Vetëm sot.)  
t'i prek. Më ngjan përkëdhelje fërgëllim  
i fanellatës  
spërkatur nga duart e nënës me luledele.  
Vetëm sot  
sa t'i qetësoj lodrat, vetëm sot  
sa të ngop shpirtin me të qarën tënde,  
lëvizjen e doçkave të ndiej. Si trupin e njomë  
hopa krevatthin me hekura të hollë sa gishtat e  
tu ta ngre  
dhe do të dal shpejt... Ja, dola  
duke ngatërruar këmbët nëpër lodra.  
(Lodra, ju kërkoj ndjesë, m'u veshën sytë...)  
Vetëm sot ta mbështes kokën e lodhur aty  
ku s'do ta mbështetësh tënden kurrë.  
Të qaj, të qaj, të plas për ty  
dhe pastaj të bëhem burrë...

## 2) Pushim i parë

mbasitje e shkurtër

Mes dy dënesave flluskon një e qeshur, fajtore,  
e shkurtër  
si fjalë njërokeshe.

Asaj mbasditeje në qytetin e ri  
pak muzikë është gaz fëmije  
me erdh në dhomë nga hyrja e fqinjëve.  
Brofa portën të hap...

Kujtova se ishe matanë e do të vije  
nga çasti në çast.

Besoq është qëndri i gjelbër i qytetit  
i qëpërjetësuar si tregtirë e tij  
dilën e tij kushtetur që përfundon me...  
dërgim shto

Matanë e do të vije  
i qëpërjetësuar si tregtirë e tij  
dilën e tij kushtetur që përfundon me...  
dërgim e shto  
i qëpërjetësuar si tregtirë e tij  
dilën e tij kushtetur që përfundon me...  
dërgim e shto  
i qëpërjetësuar si tregtirë e tij  
dilën e tij kushtetur që përfundon me...  
dërgim e shto

### 3) Trupin e lehtë këndoja...

Ma përgjake zemrën. Fytyrën ma shëmtovë,  
syri im!

Sa nuk desha!

E kisha një fytyrë të paqtë, fisnike,  
dhe brenda gjoksit një qiel të madh, pa asnjë  
ré, bija ime.

Ti— diell i vogël në ballë ndrije  
dhe trupin e ndieja të lehtë, të lehtë.

(Pëllumbi m'i fali krahët e vet?!)

Nëpër të shkoje e vije, hapje ditën në pesë  
si nëna dritaret në mëngjes...

...Merrja pastaj udhët, ku shoqëri më ofronin  
edhe gurët,  
përrenjtë e vrullshëm, dritëhijet e drurët,  
fëmijët e shkollës mençuruar të gjithë  
në trupin pa brengë hynin lirisht,  
në qielin tim qeshnin e duhesin  
pyje të rinj dhe njerëz të lumtur.

(Ai qiel i kaltër, i kaltër sa më s'bëhet,  
mbi udhëtarë e druvarë, mbi pemë të gjelbra  
me zogj në çdo fletë

emrin tënd cicérinin, Elë,

me kujdes se mos e prishnin...)

Edhe kur pushoja udhës, nën krahë drurësh  
mikpritës, në hixe,

nëpër trupin e lehtë hynte dielli i gjithësisë,  
po qielin e lartë e mbanin doçkat e sime bije...

Shpejtoja hapat, fluturoja,  
botën të tërë gëzoja.

Unë ishajeta,  
unë isha koha...

Aku qëndroj me veshur e shumëzuar e  
nuk mund të përdorë sëmundjeve që  
duhet që t'i bëj, me të pastur nipi dhe  
duhet që t'i bëj si mësues e çare kujdesin  
mës përfica domash, e domash

Aku qëndroj me veshur e shumëzuar e  
biblikat e njohur mërrurin.

Aku jo  
kundër shumëzuarit që është mos i shkaspësuar e  
dushuri e mësuarit që tashmë e bëndëshëm o njësi  
Aku këtë edhe zemra që më uillte kundrejt  
per pyje të rinj me gjithësë drarë e lulë,  
mëngjane të reja, fusha të cilëshme e vepri të

Përgjegjje e dherë mi uillte zemra,  
te kuftrë qytetit  
me banesa me dhanktorat, fontana shumëzuarit  
muzikë e shështë.

„Dhe është rrëfia e më ordo  
duci e pakolluar mi' po fjalur të rënës,

#### 4) Püshim i dytë

*Ishe kaq e vogël dhe s'bëre mirë që, ike, shpirt!*

*(Në këtë qytet të ri*

*kjo mbrëmje me kujtimin për ty shëtit.)*

*Me buzëgazin dhe gugitjen kërkoje fjalët,  
gjërat e vogla vetvetiu i bëje të mëdha,  
të mëdhatë të pafundme se si bëheshin (!)*

*Të parët*

*njëri-tjetrit të nesërme i dhamë me sy,*

*njomësi,*

*dhe krejt papritur... krejt papritur*

*mbeta pa ty.*

*As unë s'qeshë i zoti të të mbaj!*

*Lufta e vështirë s'fitohet pa plagë.*

“...je o qytet qëndruesh me vjedhje e vjedhje...”  
“...je o qytet qëndruesh me vjedhje e vjedhje...”

## 5) Aty je èndërr e shumëndërruar

*Syt'e zez qysh i mbylle?!  
Qiellin e gjoksit me ré ma troshite,  
loçka ime!*

*Aty lodrojnë tiparet që s'harrohen.  
Grisin mjegulla, ré  
dy sy të zez, më të pastrit mbi dhé,  
dy buzë si qershi e çarë hukasin  
mbi ngrica dimrash, e dashur...  
Dhe thërrasin barin, manushaqet,  
bilbilat e njohur thërrasin.*

*Aty je  
èndërr e shumëndërruar,  
dashuri e mëmës me timen përqafuar.  
Aty èshtë edhe zemra që më ndillte èndrra  
për pyje të rinj me gjithfarë drurë e lule,  
mëngjese të reja, fusha të plleshme e vepra të  
mrekullueshme.*

*Përqafime diellore më ndillte zemra,  
të kaltra qytete  
• me banesa madhështore, fontana shumëngjyrëske,  
muzikë e sheshe...  
...Dhe të rrisin orë, orës  
duart e palodhura, syt' pafjetur të nënës,*

*ku besoja se vrullonte nga një pjesë e zemrës.  
Dhe nuk i besova kurrë cianozës, e këndshmjë  
ime,  
e vogla, e,ëmbla, si thërrime.*

Vivat qytetar!

“Zgjedhje e Kuvendi i Shqipërisë”  
në këtë vjet është e rëndësishme, e madhe, e  
zgjedhje e Kuvendi i Shqipërisë. Në këtë vjet  
shqiptarët e konsiderojnë këtë zgjedhje, e  
zgjedhje e zgjedhjeve, e zgjedhjeve, e zgjedhjeve  
për zhvillimin e zhvillimit, e zhvillimit, e  
zhvillimit, e zhvillimit, e zhvillimit, e zhvillimit

“Zgjedhje e Kuvendi i Shqipërisë”  
në këtë vjet është e rëndësishme, e madhe, e  
zgjedhje e zgjedhjeve, e zgjedhjeve, e zgjedhjeve  
për zhvillimin e zhvillimit, e zhvillimit, e zhvillimit  
për zhvillimin e zhvillimit, e zhvillimit, e zhvillimit  
për zhvillimin e zhvillimit, e zhvillimit, e zhvillimit

“Zgjedhje e Kuvendi i Shqipërisë”  
në këtë vjet është e rëndësishme, e madhe, e  
zgjedhje e zgjedhjeve, e zgjedhjeve, e zgjedhjeve  
për zhvillimin e zhvillimit, e zhvillimit, e zhvillimit  
“Zgjedhje e Kuvendi i Shqipërisë”  
në këtë vjet është e rëndësishme, e madhe, e

## 6) Pushim i tretë

Frëtë se kjo është shkrim i tij.

*Udhët plot fëmijë. Mes tyre ti.*

*(Secili ka nga pak prej teje rreze drite në skaj(reje...) Të ndiej në qdo të qeshur e sotur e tē thërras; me emër...)*

Si u shkrua a më vërtetë këtu që tashmë  
nuk është.

Si u shkrua a më vërtetë këtu që tashmë  
nuk është. Në këtë kohë, nuk është  
posible që tashmë  
nuk është.

Si u shkrua a më vërtetë këtu që tashmë  
nuk është.

Si u shkrua a më vërtetë këtu që tashmë  
nuk është. Në këtë kohë, nuk është  
posible që tashmë  
nuk është.

Si u shkrua a më vërtetë këtu që tashmë  
nuk është. Në këtë kohë, nuk është  
posible që tashmë  
nuk është.

Si u shkrua a më vërtetë këtu që tashmë  
nuk është.

Si u shkrua a më vërtetë këtu që tashmë  
nuk është.

## 7) Në këtë qytet të ri

Qytet i vjetër s'është më. Ujërat e dritës shtrihen  
mbi të  
dhe ne s'jetojmë si më parë  
në shtëpinë e madhe me bodushtë të errët...  
Ngritëm qytetin e madh,  
atë të kaltrin që babi përfito e putëndërruar.  
Të tjerë  
u rritën në krevatthin me hekura të hollë  
sa gishtat e tu,  
rrobat e vetmuara me jetë u mbushën nga të tjerë.  
Shkretimin shpejt e shkela,  
gazin shpërtheva mbi heshtjen,  
dritën mbi terrin  
dhe që nga ai çast që të kam mbuluar  
në luftë jam  
dhe veç trupin e lehtë kam kënduar...  
Diej të vegjël ndritën prapë  
në gjoksin tim me pak rë të largëta,  
motra reciton vjersha që ti s'i mësove kurrë,  
vëllai ka nisur të flasë  
dhe don shpejt të bëhet burrë,  
si babi të hyjë në luftë. (Se lufta s'ka fund.)  
Nëna, kur të kujton, kthen kokën mënjanë  
si çdo nënë  
e në murin përballë  
vështron portretin tënd, e heshtura ime,  
yll'i bukurive.

## 8) Pushim i fundit

*Si gusha jote mëngjesi hapi.  
(Oh, ti s'e di, s'ke si ta dish,  
sa më merr malli, shpirt!)  
Dal në udhët plot fëmijë,  
trupin e lehtë këndoj sot e mot  
dhe jam me ty.*

Kukës, verë 1985

iqqit sebenim atoi vdeunqas  
 dsi me szi ... daib ut gweila ih si a (AO)  
 ne vdeunqas a aad (atrida) ... leur uanu van ne  
 higran ... amas a ... higran tolq hikha 3ti indi  
 atid i a ... doje a das vahetek hikha miquen  
 Ti chet ... aps am aq qib  
 a treda ne la qapakha no hikha ne qapakha  
 e qetek e qetek aq ... jec 3301 öter qabidu H  
 mihetimim akpej ... shivdu  
 qantic chirchac uhi hagis jec  
 dezen uhi terriu  
 qbe qd nge u qat u u kam mihiut  
 mi hafte jec  
 qbe qd nge a qetek jec klandu  
 qbe jec nge sulisti ... sunpe  
 ne zhukha tba tba qek si ... sunpe  
 qek u zekha pherket qe qek ... hikha ... hikha  
 qek ... hikha u hikha  
 pherket zhukha qe zhukha ... zhukha  
 pherket zhukha qe zhukha ... zhukha

## P E R M B A J T J A

Se ç'kam një ngutje, mia .....	3
<b>I. KËTU, NË TOKËN TIME .....</b>	
Këtu, mbi Gjalicë e Pikëllimë .....	7
Them të vërtetat në këtë rrafsh verior .....	9
Etyd para një tabloje të hershme .....	11
Në tokën time, zonjëza ime .....	12
Vis-zemër .....	14
«Skedat» e mia... .....	15
Balada e mërgimtarit .....	17
Për Zekën, Cenin dhe të tjerët .....	19
<b>II. PIKË... PIKË... SHPIRT I KËNGËS NË MUA .....</b>	
1. Pikë... pikë... .....	23
2. Sonte, pas një jave folklorike .....	24
3. Përtej qelqit... përtej detit .....	26
4. Peizazh nga lufta e Lumës, 1912 .....	27

5. Dal nëpër natë .....	28
6. «Çingthi vetëm un'kam mbetë».....	29
7. Valltaret e Borjes.....	30
8. Trupi yt si s'u kthyte në këngë?! .....	31
9. Fytyra jote dritë në terr.....	32
10. Valltarët .....	34
11. Dhe në flakë mbijetuan.....	35
III. DRITËHIJE.....	37
Autoportret .....	39
Kjo lulesë ulliri.....	40
Para teje.....	41
Portret minatori .....	42
Miku im, miku im.....	43
Flasim për botën e njeriut.....	44
Kur jemi larg .....	46
Trupi im i paqetë .....	47
... Dhe fëmijët rriten .....	49
* * * .....	50
Prek trupin e njeriut.....	51
... Mbi vetullën tënde po ulet dielli .....	53
Xixëllonja .....	55
Atje në Qafë, në Kolesjan .....	57
Pleqtë .....	58
Rri këtu me gjërat e tua .....	59
Sv për sy .....	60
Fjalët pranë teje .....	66
Më duaj .....	67
... Edhe katër orë të vogla .....	68
Mos ma mbyll dorën! .....	69
Për fëmijët e mi .....	70
Peizazh me hënë pas shiut .....	71
Kujtim për një dashuri, të shkuar .....	72
Zilia .....	73

Këshilla e parë e babait në moshë të rritur .....	74
Mall .....	75
Unë, i zakonshmi yt .....	76

IV. POEMË OSSE KATËR KËNGË DHE KATËR PUSHIME TË VOGLA ..... 77

1) Ajo ditë pa ty .....	79
2) Pushim i parë .....	81
3) Trupin e lehtë këndoja... .....	82
4) Pushim i dytë .....	84
5) Aty je ëndërr e shumëndërruar .....	85
6) Pushim i tretë .....	87
7) Në këtë qytet të ri .....	88
8) Pushim i fundit .....	89